

VENDIM
Nr. 48, datë 3.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar; të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; si dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 3, togfjalëshi “si dhe të nenit 1 pika 4, shkronja “b” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “të nenit 1, pika 4, shkronja “b” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji për parandalimin e pastrimit të parave.”;

b) Në nenin 4, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, togfjalëshi “nr. 52/2016, datë 19.5.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, zëvendësohet me togfjalëshin “për SHKK-të, ligjin për parandalimin e pastrimit të parave”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohen shkronjat “e”, “f” dhe “g”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“e) *“aksione të mbajtësit (bearer shares)” - janë aksione të një personi juridik, pronësia e të cilave i kalon personit që zotëron/mban certifikatën/dokumentin e aksioneve të mbajtësit, pa pasur nevojë për marrëveshje/kontratë për kalimin e pronësisë së këtyre aksioneve;*

f) *“aksioner përfaqësues (nominee shareholder)” - është aksioneri i regjistruar i një personi juridik, që mban aksionet në emër të aksionerit aktual (pronarit përfitues), në bazë të një marrëveshjeje;*

g) *“bankë guaskë”- është një bankë, e cila nuk ka prani fizike, përfshirë mungesën e administrimit e drejtimit, si dhe nuk është e përfshirë në një grup të rregulluar financiar.”;*

i) Në nenin 5, pas pikës 9, shtohet pika 9/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“9/1. Në rast se Banka e Shqipërisë konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit apo burimi i tij lidhet me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me anëtarët/donatorët, apo lidhet me shoqëri të regjistruara në parajsa fiskale ose offshore, njofton dhe kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nëse ka informacion në lidhje me anëtarët/donatorët, si dhe pezullon procedurën e licencimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.”.

c) Në nenin 6, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2, shkronja “f”, pas nënpikës “i”, shtohet nënpika “ii”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“ii. deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 10/1 të kësaj rregulloreje).”

ii) Në pikën 2, shkronja “g”, pas nënpikës “i”, shtohet nënpika “ii”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“ii. deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 10/1, të kësaj rregulloreje).”

iii) Në pikën 2, shkronja “h”, pas togfjalëshit “të kësaj rregulloreje”, shtohet togfjalëshi “, ku identifikohen edhe rreziqet, ndaj të cilave subjekti parashikon të ekspozohet, përfshirë edhe rreziqun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit”;

iv) Në pikën 2, shkronja “i”, togfjalëshi “duke përfshirë një program masash”, zëvendësohet me togfjalëshin “duke parashikuar edhe një program masash, përfshirë edhe për donatorët e SHKK-së,”;

d) Në nenin 7, pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“4/1. Banka e Shqipërisë, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim Taksave, etj.”;

e) Në nenin 8, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“1/1. Banka e Shqipërisë, përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, refuzon licencën edhe kur:

a) gjykon se licencimi do të cenonte interesat e publikut; si dhe

b) vërtetohet një nga kushtet e mëposhtme, për të paktën njërin nga anëtarët themelues/donatorët:

i) zotëron aksione të mbajtësit (bearer shares), ose është aksioner përfaqësues (nominee shareholder);

ii) ka një strukturë komplekse të pronësisë dhe kontrollit;

iii) është një bankë guaskë;

iv) paraqet rreziq të lartë, bazuar në vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.”;

ii) pika 2, shfuqizohet;

f) Në nenin 13, kudo pas fjalës “emërimit”, shtohet fjala “/riemërimit”;

g) Në nenin 14, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “g/1”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“g/1) deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 10, të kësaj rregulloreje);”.

ii) Në pikën 1, shkronja “h”, fjalja e fundit, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Dokumentet e lartpërmendura në shkronjën “h”, të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.”;

iii) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. SHKK-ja/Unioni, në rastet e riemërimit të kryetarit të këshillit drejtues, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

b) CV-në e përditësuar, të plotësuar sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje;

c) një informacion/relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e kryetarit të këshillit drejtues, të administratorit dhe të kryetarit të komitetit të kontrollit, në drejtimin efektiv të SHKK-së/Unionit;

d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykojnë të nevojshme.”.

iv) Në pikën 3, togfjalëshi “1 dhe 2”, zëvendësohet me togfjalëshin “1 deri 2/1”;

- h) Në nenin 16, pika 1, shkronja “b”, pas fjalës “emërojë” shtohet fjala “/riemërojë”;
- i) Në nenin 17, pika 1, shkronja “a”, nënpika “iii”, pas togfjalëshit “dhe të sigurisë” shtohet togfjalëshi “sipas rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare””;
- j) Në nenin 20, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i) Në pikën 2, shkronja “f”, pas togfjalëshit “kësaj rregulloreje”, shtohet togfjalëshi “ku prezantohen edhe rreziqet, ndaj të cilave subjekti parashikon të ekspozohet, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit”;
- ii) Në pikën 2, shkronja “g”, nënpika “v”, togfjalëshi “duke përfshirë një program masash”, zëvendësohet me togfjalëshin “duke parashikuar edhe një program masash, përfshirë edhe për donatorët e Unionit”;
- k) Në nenin 22, pika 1, shkronja “b”, pas fjalës “emërojë”, shtohet fjala “/riemërojë”;
- l) Në nenin 24, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i) Në pikën 2, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “g/1”, me përmbajtjen e mëposhtme:
- “g/1) deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përvaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 10 të kësaj rregulloreje)”;
- ii) Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen e mëposhtme:
- “3/1. Unioni, në rastet e riemërimit të drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit ndaj SHKK-ve, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni;
- b) CV-në e përditësuar, të plotësuar sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje;
- c) një informacion/ relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e drejtuesit, në drejtimin efektiv të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit ndaj SHKK-ve;
- d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykohen të nevojshme.”;
- iii) Në pikën 4, togfjalëshi “2 dhe 3”, zëvendësohet me togfjalëshin “2 deri në 3/1”;
- m) Në nenin 25, pika 2, pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g” me përmbajtjen e mëposhtme:
- “g) një përshtetëse të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të SHKK-së përthithëse, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të bashkimit me përthithje, dhe të mënyrës se si sistemet e administrimit të rrezikut do të integrohen brenda një afati kohor të arsyeshëm.”;
- n) Në nenin 26, pika 2, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me përmbajtjen e mëposhtme:
- “d) një përshtetëse të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të SHKK-së së re, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të bashkimit me krijim, dhe të mënyrës se si sistemet e administrimit të rrezikut do të integrohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.”;
- o) Në nenin 27, pika 2, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “f” me përmbajtjen e mëposhtme:
- “f) një përshtetëse të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të SHKK-ve pritëse, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të ndarjes me përthithje.”;
- p) Në nenin 28, pika 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e”, me përmbajtjen e mëposhtme:
- “e) një përshtetëse të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të SHKK-ve pritëse, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të ndarjes me krijim.”;
- q) Pas nenit 33, shtohet neni 33/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 33/1
Procesi i rivlerësimit

1. SHKK-të dhe Unioni kryejnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe të drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykohet e nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.

2. SHKK-të dhe Unioni, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, sigurojnë plotësueshmërinë në vazhdimësi, të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë rezultatet e procesit të rivlerësimit, mbi baza vjetore, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. SHKK-të dhe Unioni dokumentojnë procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë së anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, si dhe parashikojnë detyrimin për të gjithë këta persona që të njoftojnë SHKK-në/Unionin për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që vazhdojnë të plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë rregullore.

4. Në rastet kur SHKK-të dhe Unioni konstatojnë mosplotësimin e kriterëve të parashikuara në këtë rregullore, nga anëtarët e këshillit drejtues, administratori, anëtarët e komitetit të kontrollit dhe drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë, por jo më vonë se brenda 5 ditëve pune nga konstatimi.

5. Banka e Shqipërisë, pas njoftimit sipas pikës 4 të këtij neni, por edhe nëse e konstaton këtë fakt gjatë ushtrimit të procesit të saj mbikëqyrës, ka të drejtë të urdhërojë shkarkimin e anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit.

r) Në nenin 34, togfjalëshi “e parashikuara në ligjin për SHKK-të”, zëvendësohet me togfjalëshin “e parashikuara në kreun X të ligjit për SHKK-të”;

s) Në formularin 7, pas pikës 9, shtohet pika 10 me përmbajtjen e mëposhtme:

“10. Përshkruhen rreziqet ndaj të cilave SHKK-ja/Unioni parashikon të ekspozohet gjatë zbatimit të planit të biznesit (përfshirë edhe rreziqun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit), si dhe metodat dhe sistemet e kontrollit që do të zbatohen prej saj/tij për administrimin e këtyre rreziqeve. SHKK-ja/Unioni, në hartimin e planbiznesit dhe në llogaritjen e treguesve për rreziqet e parashikuara, duhet të marrë në konsideratë kërkesat e ligjit “Për shqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, veçanërisht për normat dhe kufijtë maksimalë të treguesve të rreziqeve.”;

t) Pas formularit 9, shtohen formularët 10 dhe 10/1, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rregullat e parashikuara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, do të zbatohen vetëm për procedurat e nisura pas hyrjes në fuqi të tij.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç shkronjës “q”, të pikës 1, të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi më datë 31.12.2019.

KRYETAR
Gent Sejko

ANEKSI 1

“FORMULARI NR. 10

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës, unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim. Në rastin kur anëtar i këshillit drejtues, administratori, anëtar i komitetit të kontrollit dhe drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me anëtarin e këshillit drejtues, administratorin, anëtarin e komitetit të kontrollit dhe drejtuesin e njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë/SHKK-së/Unionit _____.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë/SHKK-ja/Unioni _____.

(Emri/Mbiemri i anëtarit të këshillit drejtues/administratorit/ anëtarit të komitetit të kontrollit/drejtuesit të njësisë organizative përgjegjëse për monitorimin)

_____/_____/_____
(Data)

(nënshkrimi i plotë)

FORMULARI NR. 10/1

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës, unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim. Në rastin kur anëtarit themelues/donatori i SHKK-së/Unionit deklaroi se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me anëtarin/donatorin	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Emri/mbiemri i anëtarit themelues/donatorit)

____/____/____

(data)

(nënshkrimi i plotë)”